



## KONCEPTI STRATEGJIK NATO - 2022 DHE PERIMETRI I BASHKËPUNIMIT STRATEGJIK ME BE-në

Dispozitat bashkëpunuese të sigurisë të përcaktuara në Konceptin Strategjik të NATO-s - 2022 dhe orientimi Strategjik i BE-së ofrojnë një kornizë të plotë dhe praktike për forcimin e bashkëpunimit në funksion të sigurisë Euroatlantike. Përgjigja e Europës për sigurinë ndaj luftës së Rusisë në Ukrainë sugjeron se arritja e autonomisë strategjike europiane ekziston në një afat kohor të zgjatur. Në një periudhë të afërt,

integrimi i thelluar i mbrojtjes midis Bashkimit European (BE) dhe NATO-s do të mbështesë modernizimin e aftësive dhe ndërveprueshmërinë duke zgjeruar rrjetet europiane të prokurimit të pajisjeve në fushën e mbrojtjes si një domosdoshmëri koherente. Përpjekjet për të zgjeruar integrimin e mbrojtjes në BE ka marrë përparësi ndërtimit të institucioneve dhe kornizave të gjera konceptuale mbi zgjidhjet e poli-

tikave të zbatueshme për sigurinë. Megjithatë, përmirësimi i kapacitetit operacional të BE-së kërkon iniciativa praktike, duke përfshirë investime të konsiderueshme në kapacitetet ushtarake dhe rritjen e shpenzimeve të mbrojtjes nga qeveritë e vendeve të saj. Së fundi, rezultati i luftës dhe kërcënimet hibride janë të gjera dhe të pasigurta të cilat rrisin urgjencën e zbatimit të iniciativave politike dhe pragmatike të... » faqe 6



## Komisioni Parlamentar për Sigurinë Kombëtare vizitë në SHP Gjeneral brigade Arben Kingji: Mjedisi i sotëm i sigurisë, i paqëndrueshëm dhe sfidues



*FA-të duhet të jenë të përgatitura dhe të gatshme për të vepruar në kohë dhe në çdo skenar të mundshëm*

### Kolonel Beqir Tafilaj merr detyrën e shefit të Shtabit të Forcës Tokësore

Kolonel Beqir Tafilaj merr detyrën e shefit të Shtabit të Forcës Tokësore. Në prani të shefit të Shtabit të Përgjithshëm gjeneral brigade Arben Kingji, kolonel Tafilaj, pasi falënderoi për vlerësimin në këtë detyrë liderin politik dhe atë ushtarak, u zotua për përkushtim dhe përgjegjësi të plotë në realizimin e objektivave të kësaj force.



### “Bëhu zëri jashtë korit. Bëhu pesha që anon majën”

“Arsimim nuk do të thotë të Amësosh përmendësh se Hitleri vrau gjashtë milionë njerëz. Arsimim është të kuptosh se si ishte e mundur që miliona njerëz u bindën se ishte e nevojshme për ta bërë këtë. Arsimi na mëson të njohin të fshehtat e historisë, nëse, dhe kur ajo përsëritet.” Ne kemi dy zgjedhje përpara: të bëjmë atë që bëjnë të gjithë, të shikojmë shumë televizor, të ndjekim mendimet e masës, ose të përçojmë filozofinë tonë. Mos lexoni, mos studioni, mos informoni veten...”



### Tre nëntor 1443, epopeja e lavdisë së Skënderbeut

Shqiptarët e vazhduan luftën kundër pushtuesve osmanë në formë të ndryshme edhe pas kryengritjeve të viteve '30 të shek. XV. Nëpër dokumente të gjysmës së dytë të viteve '30 dhe fillimit të viteve '40 përmenden në viset shqiptare spahinj të vvarë, spahinj që, për të shpëtuar kokën, kishin braktisur timaret etj. Qëndresa e përhershme kundër pushtuesve osmanë dhe rrethanat e favorshme ndërkombëtare që u krijuan në fund të viteve '30 e në fillim të viteve '40 të shek. XV nxitën disa nga fisnikët shqiptarë të ngriheshin në luftë...





*Kolonel Beqir Tafilaj  
merr detyrën e shefit  
të Shtabit të Forcës  
Tokësore.*

## Kolonel Beqir Tafilaj merr detyrën e shefit të Shtabit të Forcës Tokësore

*Në prani të shefit të  
Shtabit të Përgjith-  
shëm gjeneral brigade  
Arben Kingji, kolonel  
Tafilaj, pasi falënderoi  
për vlerësimin në këtë  
detyrë liderin politik  
dhe atë ushtarak, u zo-  
tua për përkushtim dhe  
përgjegjësi të plotë në  
realizimin e objektivave  
të kësaj force.*



**Organizimi i skuadrës/  
togës për patrullim kufit-  
ar, si dhe ngritja e postës  
së vrojtimit, ishte tema e  
mësimit tregues të reali-  
zuar në batalionin e Tretë  
të Këmbësorisë, nga efek-  
tivët e kompanisë së Dytë  
të këtij reparti gjatë  
kësaj jave.**



## KOMISIONI PARLAMENTAR PËR SIGURINË KOMBËTARE VIZITË NË SHP

## Gjeneral brigade Arben Kingji: Mjedisi i sotëm i sigurisë është bërë i paqëndrueshëm dhe sfidues

*FA-të duhet të jenë të përgatitura dhe të gatshme për të vepruar në kohë dhe në çdo skenar të mundshëm*

**K**omisioni Parlamentar për Sigurinë Kombëtare, zhvilloi një vizitë njohëse në ambientet e Shtabit të Përgjithshëm të FA-së, ku u pritën nga shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH, gjeneral brigade Arben Kingji.

Gjithashtu pjesëmarrës në këtë takim ishin edhe sekretarja e Përgjithshme në Ministrinë e Mbrojtjes, znj. Geraldina Prodani si dhe drejtori i Shtabit të Përgjithshëm, kolonel Arben Zani.

Qëllimi i kësaj vizite ishte njohja me situatën e sigurisë në rang kombëtar, rajonal dhe në arenën ndërkombëtare.

Anëtarët e Komisionit Parlamentar për Sigurinë Kombëtare, u njohën gjithashtu me vizionin e shefit të Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, gjeneral brigade Arben Kingji, të zhvillimit të FARSH, për periudhën 2022 - 2025.

Me anë të një prezantimi, gjeneral brigade Kingji i njohu ata me vizionin e FARSH për tre vitet e ardhshme, duke marrë në konsideratë: dokumentet strategjike, Programin e Qeverisë 2021 - 2025, detyrimet kombëtare dhe ato në NATO, Konceptin e Ri Strategjik të NATO-s dhe Modelin e ri të Forcës së NATO-s. Në fjalën e tij, gjeneral brigade Kingji u shpreh ndër të tjera: "Mjedisi i sotëm i sigurisë është bërë i paqëndrueshëm dhe sfidues. Ndaj, FA duhet të jenë të përgatitura dhe të gatshme për të vepruar në kohë dhe në çdo skenar të mundshëm. Ndërkohë, Koncepti i Ri Strategjik 2022 dhe Modeli i Ri i Forcës së NATO-s, angazhimet jashtë vendit në kuadër të procesit të anëtarësimit në BE, janë një detyrim i shtuar për Forcat tona të Armatosura. Synohet një Forcë e Armatosur, e mirë pajisur me armatim dhe teknikë, e mirë trajnuar, stërvitur dhe e motivuar, e gatshme dhe e aftë, të kryejë misionin e saj kushtetues dhe të përmbushë detyrimet euro-atlantike, duke vepruar në mënyrë të pavarur dhe/ose në përbërje të Aleancës."

Më tej, gjatë prezantimit, gjeneral brigade Kingji renditi prioritetet për tre vitet e ardhshme, si më poshtë:

1. Modernizimi, zhvillimi dhe rritja e kapaciteteve dhe aftësive operationale të FA-së.
2. Konsolidimi, ruajtja dhe zhvillimi i mëtejshëm i kapaciteteve të GBKL.
3. Zhvillimi dhe rritja e kapaciteteve të SOLTG;
4. Konsolidimi dhe zhvillimi i kapaciteteve të EOD;
5. Zhvillimi i kapaciteteve të MADM
6. Zhvillimi i kapaciteteve kibernetike.
7. Aktivizimi dhe organizimi i Komponentit Rezervist në FA.
8. Përmirësimi i paketës ligjore ushtarake.
9. Përmirësimi i sistemit të rekrutimit, përkujdesjes dhe promovimit të ushtarakëve.



Konsolidimi i sistemit të arsimimit ushtarak.

Synimi i SHSHPFA është zhvillimi i Forcave të Armatosura, me aftësi dhe kapacitete të zgjidhin me sukses situata të krizave të ndryshme dhe të kryejnë shërbime të ndjeshme e jetike, për

nevoja të brendshme dhe detyrime jashtë vendit.

Në emër të anëtarëve të Komisionit Parlamentar për Sigurinë Kombëtare, pjesëmarrës në këtë takim, përshëndeti, zëvendëskryetari i këtij komisioni, z. Xhemal Qefalia,

i cili pasi adresoi një falënderim të veçantë për SHSHPFA, gjeneral brigade Arben Kingji për pritjen dhe të zhvillimin e këtij takimi njohës dhe informues mbi Planin e Zhvillimit të Forcave të Armatosura, vlerësoi me nota shumë pozitive vizionin e

gjeneral brigade Kingjit për Forcat e Armatosura për tre vitet e ardhshme, duke u shprehur besimplotë që FARSH nën drejtimin e gjeneral brigade Kingjit do vijoje të shërbejë më së miri në të gjitha fushat e mbrojtjes, brenda dhe jashtë vendit.

**Zhvillohet në Forcën Tokësore analiza pas veprimit, e stërvitjes certifikuese "BIZA-22" e Grup Batalionit të Këmbësorisë së Lehtë (GBKL)**

*Alpinizmi kërkon kurajë dhe përgatitje të lartë fizike dhe profesionale. Efektivët e batalionit të Dytë të Këmbësorisë, treguan se i zotërojnë më së miri këto aftësi.*



*Kursi i XVIII "Komando", i Regjimentit të Operacioneve Speciale (ROS), përfundon me sukses stërvitjen ujore.*



**Efektivë të batalionit të Dytë të Këmbësorisë dhe ata të Forcës së Sigurisë së Kosovës, shkëmbyen eksperiencën e tyre, gjatë një trajnimi të përbashkët afro njëmuajor**



# "Bëhu zëri jashtë korit. Bëhu pesha që anon majën"

ANJEZA MUSOLLARI,  
Shefe e Sektorit të Botimeve

“Arsimim nuk do të thotë të mësosh përmendësh se Hitleri vrau gjashtë milionë njerëz. Arsimit është të kuptosh se si ishte e mundur që miliona njerëz u bindën se ishte e nevojshme për ta bërë këtë. Arsimi na mëson të njohin të fshehtat e historisë, nëse, dhe kur ajo përsëritet.”

Ne kemi dy zgjedhje përpara: të bëjmë atë që bëjnë të gjithë, të shikojmë shumë televizor, të ndjekim mendimet e masës, ose të përçojmë filozofinë tonë.

Mos lexoni, mos studioni, mos informoni veten në mënyrë pasive. Hapni librat, shfletoni ato, pyesni. Gjithmonë pyesni veten: “pse ndodhi kjo, pse X-i veprimi në këtë mënyrë, çfarë e shtyu Y-in të shkruante pikërisht këtë?” Vendosni historinë, filozofinë, politikën, letërsinë tek “pse”. Mësoni të kultivoni dyshimin. “Bëhu, - siç thotë Russell, - zëri jashtë korit. Bëhu pesha që anon majën.”

Sot ka shumë intelektualë të shkolluar por pak të arsimuar. Njerëzit e kohës sonë do të paguajnë më shumë për t’u argëtuar se sa për t’u arsimuar. Mësimi përfundon në klasë, arsimi fillon në shtëpi. Njeriu që nuk lexon asgjë është shumë më i arsimuar se sa ai që nuk lexon asgjë tjetër përveç gazetës. Titulli akademik dhe shkencor nuk të bën intelektual. Edukimi i mendjes pa edukimin e shpirtit nuk mund të quhet edukim i mirëfilltë. Niveli i qytetërimit të një shoqërie matet dhe tregohet në nivelin e shprehjes së fjalës publike. Fjala e shprehur vepron më shumë se ajo që lexohet në libër.


Shkollimi është i nevojshëm dhe shumë i rëndësishëm, sepse arsimi e ndihmon gjeneratën e re të formohet dhe të edukohet në mënyrë të drejtë dhe me përgjegjësi. Procesi që e shoqëron njeriun prej ardhjes në këtë botë e deri në vdekje është arsimimi gjatë gjithë jetës, me qëllim të ndryshimit të vetvetes së tij në çdo etapë të jetës. Edukimi si emërtim ka përkufizime të ndryshme.

Sa herë përmendim edukatën, mendja na shkon tek edukata e fëmijëve, apo përmes edukimit synojmë të njohim sa më shumë veten, shoqëritë e zhvilluara vetëm në sajë të edukimit kanë mbërritur në stadin që janë sot.

**Shtrohet pyetja se, ku jemi ne si shoqëri me edukatën?**

Në vitet e fundit shoqëria jonë po përballët me probleme të shumta si papunësia, varfëria, pasiguria, diskriminimi, korrupsioni, kriminaliteti, dhuna verbale e fizike, sëmundjet, lëndët narkotike, terrorizmi, fanatizmi fetar etj., gjë që këto probleme kanë krijuar një pasiguri për popullsinë, dhe si rezultat i këtyre problemeve shoqëria mund të ketë arsye që më shumë t’i frikësohet jetës sesa vdekjes, më shumë urisë sesa sëmundjes, më shumë të ardhmes se të tashmes.

Synim i edukatës nuk është vetëm edukimi i të rinjve, nxënësve apo studentëve. Qëllimi i saj është që një shoqëri të jetë e shëndoshë dhe të respektojë rregullat e jetës pa marrë parasysh moshën të cilës i takon. Për këto, dhe arsye të shumta, njeriu në liri sot nuk është i lirë, në siguri ndjehet i pasigurt në shoqëri ndjehet i vetmuar. Në rënien e edukatës kanë ndikuar shumë faktorë si familja, shkolla, shoqëria dhe mediat elektronike, duke shfaqur emisione me tema të ndryshme joadekuate për rrethin tonë shoqëror. Po ashtu në rënien e saj kanë ndikuar edhe shumë udhëheqës



të emisioneve televizive: politikanë, analistë, artistë, që duke u paraqitur në televizione të ndryshme, duke mos iu përmbajtur kodit etik të veshjes, duke përdorur fjalë banale, ofendime, ngritje të zërit, duke mos respektuar njëritjetrit gjatë debatit dhe veprime të tjera që në një formë a tjetër kanë ndikuar.

Një nga problemet më të mëdha të kohës sonë është se shumë janë të shkolluar, por pak janë të arsimuar (të edukuar) mirë. Qysh në antikitetin e lashtë Aristoteli, babai i filozofisë thoshte: “I arsimuari ndryshon aq shumë nga i paarsimuari, si i gjalli nga i vdekuri. Sot ka shumë intelektualë të shkolluar por pak të arsimuar. Për shkak të krizës së jetës familjare, të shkatërrimit të tipit tradicional të familjes, shthurjes morale, sidomos gjenerata e re dhe të revolucionit post-modern, ku martesa nuk është më qëllim jete, ku familja gjithnjë e më tepër po ngushtohet.

Një komb që lë pas dore rininë e tij, që i braktis ata, vë në rrezik identitetin e tij.

Shtetet që duan të garantojnë të ardhmen, nuk mund të jenë indiferent për edukimin e shtetasve të tyre. Institucionet arsimore kanë një rëndësi jetike për rritjen e brezit të ri të shëndetshëm dhe sigurimin e një sistemi shoqëror të shëndoshë.

Arsimi duhet të konsiderohet si një laborator mjekësor, që ofron mjekimin për çdo sëmundje që sistemi shoqëror ka. Janë mësuesit pikërisht ata që duhet të gjejnë diagnostifikimin e kësaj shoqërie.

Kur njerëzit janë të arsimuar, ata mund të kontribuojnë ndjeshëm në familjet dhe shoqërinë e tyre në aspekte dhe fusha të ndryshme, duke krijuar kështu një komunitet të qëndrueshëm dhe stimules.

**Rëndësia e Edukimit në një Shoqëri**

Arsimi është një themel në të cilin zhvillimi dhe përparimi vijnë në shoqëri. Ka arsye të ndryshme pse arsimi është i rëndësishëm dhe i pranuar botërisht. Sa më pak i arsimuar një popull aq më lehtë është për t’u nënshtruar, aq më i vështirë është progresi dhe zhvillimi i tij.

**Dëshira për shkrim dhe lexim**

Në thelb, shkrimi dhe leximi përkufizohen si aftësia për të lexuar dhe shkruar. Shkalla e shkrimit dhe leximit të një vendi varet nga marrja e shkolllimit të qytetarëve të tij. Analfabetizmi, burimi i prapambetjes, i krimit, drogës, prostitucionit.

Por, për një shoqëri, problem i vetëm nuk është veç kjo kategori, por dhe ajo e analfabetit funksional, ajo që prish formatin e zhvillimit institucional.

Nuk është analfabet veç ai që nuk shkruan e nuk lexon, por ai që nuk di kuptimin e asaj që shkruan apo që lexon. Ne e kemi trashëgimi analfabetizmin funksional për shkak se vijmë nga diktatura, ku njerëzit nuk mendonin, por thjesht tundnin kokën, në shenjë pohimi, pa e kuptuar çfarë ishin duke aprovuar.

**Zhvillimi i ekonomisë**

Arsimi është një burim koheziv i mbështetjes dhe stabilitetit në zhvillimin e vendeve. Një ekonomi e qëndrueshme e një vendi është e lidhur ngushtë me arsimin. Njerëzit e ditur të një shoqërie

qytetarësh të ditur.

**Shoqëria e përmirësuar**

Në shoqërinë e sotme, të kesh një arsim konsiderohet pjesë jetike dhe e rëndësishme për cilësinë e jetës, jo vetëm personale, por dhe atë sociale. Një vend që prodhon njerëz të arsimuar, prodhon dije dhe bën që shoqëria të ndihet e dobishme.

**Sigurimi i një jete të begatë**

Arsimi është vendosur gjithmonë lart në shoqëri. Për të siguruar një mënyrë jetese të rehatshme, njerëzit duhet të arsimohen dhe të marrin një punë të paguar mirë për të qenë të suksesshëm dhe të kënaqur.

Ndihmon për të fituar një reputacion më të mirë dhe rrit shanset për të ngjitur shkallët e suksesit më lehtë dhe më shpejt se të tjerët që nuk janë të arsimuar. Kthimi në komunitet

Njerëzit që janë të arsimuar e kuptojnë se sa e vlefshme është të jetosh në një komunitet të qëndrueshëm dhe të sigurt. Ata kanë më shumë gjasa të marrin pjesë në projekte që ndihmojnë në përmirësimin jo vetëm të lagjes së

pagesë të lartë.

Studimi i vështirë, kushtimi i kohës dhe përpjekjeve për të fituar njohuri dhe për arritjen e një niveli të lartë kompetencash, do ndihmonte për arritjen e jetesës së rehatshme, dhe me standardet e duhura.

Punëdhënësit e shohin përvojën arsimore si një avantazh të madh sepse të gjithë preferojnë një fuqi punëtore të përgjegjshme dhe me njohuri në organizatat e tyre.

**Kalimi i hendekut**

Edukimi dixhital i ndihmon njerëzit dhe organizatat të lidhen në mbarë botën. Kufijtë nuk janë më aty.

Të jesh në gjendje të komunikosh dhe të ndash mendime me njerëz nga vende të tjera, kultura, tradita, histori të ndryshme nga të tuat, pa diskutim të vlera për vetë zhvillimet social-politike qindra vjeçare të tyre, horizontet tona janë zgjeruar “vullnetarisht” dhe kjo na ndihmon të kuptojmë dhe vlerësojmë më mirë njëri - tjetrin.

**Rëndësia e arsimit**

**për një individ**

Një edukim i mirë e bën një individ të zhvillohet personalisht, ekonomikisht dhe të jetë social. Edukimi na ndihmon të bëjmë aktivitetet tona të përditshme të jetës në mënyrat më të mira të mundshme.

Jeni nga ata që mendojnë se arsimi është i mbivlerësuar? Ky artikull do t’ju bëjë të ndryshoni mendje.

**Vlerat morale dhe etike**

Çdo gjë që e shtyn një individ të mendojë dhe të marrë parasysh, pasojat e veprimt duhet të çojë në marrjen e një vendimi më të mirë.

Arsimi ka çuar në miratimin e ligjeve kundër abuzimit të fëmijëve, dhunës në familje, hedhjes së kimikateve toksike, trajtimit të ujit dhe veprimeve të tjera që përmirësojnë moralin dhe etikën e shoqërive.

**Kreativiteti dhe aftësitë**

**e të menduarit**

Arsimi ose sportet mësimore përmirësojnë gjithashtu krijimtarinë e një personi. Ajo paraqet mundësinë që një person të përdorë talentet e tij në qasje novatore dhe të përfundojë më i rritur profesionalisht.

Krijimtaria e një personi u jep atyre mundësi për të arritur qëllimet e tyre. Njerëzit me arsim mund të mendojnë dhe mendojnë mirë.


Ata janë mësuar të bëjnë pyetje, të reflektojnë dhe të analizojnë - të gjitha aftësitë kritike për suksesin e mëvonshëm.

**Karakteret i një individi**

Edukimi lehtëson ndërtimin e personit, në të gjitha dimensionet e tij. Mësuesit përpigjen t’u ofrojnë studentëve të tyre një këndvështrim etik, mbi atë çfarë janë dhe çfarë disponojnë në formimin e tyre drejt të ‘nxënit’ të dijeve.

Njerëzit e arsimuar, kënaqen me eksperiencën e akumuluar, pasi shkollimi u lejon atyre një mënyrë jetese me ndikim, të lumtur, të përgatitur siç duhet dhe të balancuar.

Arsimi është themelor në shoqërinë tonë sot. Asnjëherë nuk është vonë për t’u arsimuar. Jini të arsimuar dhe gjithçka e pamundur është thjesht prova juaj e çastit.



kanë tendencën për t’u shndërruar në sipërmarrës, juristë, shkrimtarë, mjekë, artistë, inxhinierë, etj.

**Qytetarë të mirë**

Arsimi prodhon njerëz të civilizuar dhe të edukuar në shoqëri. Këta njerëz të ditur krijojnë mendimet e duhura dhe në fund lëvizin për një ekzistencë të madhe. Problemi i shkeljes së udhëzimeve dhe ligjit apo rregullave nuk do të ndeshet në asnjë mënyrë në një shoqëri

tyre, por edhe të shoqërisë. Përveç kësaj, kur njerëzit janë në gjendje të përballojnë shtëpitë e tyre, ata kanë më shumë gjasa të marrin pjesë jo vetëm në përmirësimin e banesave personale, por dhe në zgjidhjen e problemeve lokale përreth tyre.

**Të ardhura më të larta**

Njerëzit me arsimim të lartë e përvoja të ndryshme ka më shumë gjasa për të marrë punë eksperte me

NË VIJIM TË STUDIMIT TË KONCEPTIT STRATEGJIK TË NATO-S

N/KOL MCS KANAN HIMAJ

# KONCEPTI STRATEGJIK NATO - 2022 DHE PERIMETRI I BASHKËPUNIMIT STRATEGJIK ME BE-në

Dispozitat bashkëpunuese të sigurisë të përcaktuara në Konceptin Strategjik të NATO-s - 2022 dhe orientimi Strategjik i BE-së ofrojnë një kornizë të plotë dhe praktike për forcimin e bashkëpunimit në funksion të sigurisë Euroatlantike. Përgjigja e Europës për sigurinë ndaj luftës së Rusisë në Ukrainë sugjeron se arritja e autonomisë strategjike europiane ekziston në një afat kohor të zgjatur. Në një periudhë të afërt, integrimi i thelluar i mbrojtjes midis Bashkimit Europian (BE) dhe NATO-s do të mbështesë modernizimin e aftësive dhe ndërveprueshmërinë duke zgjeruar rrjetet europiane të prokurimit të pajisjeve në fushën e mbrojtjes si një domosdoshmëri koherente.

Përpjekjet për të zgjeruar integrimin e mbrojtjes në BE ka marrë përparësi ndërtimit të institucioneve dhe kornizave të gjera konceptuale mbi zgjidhjet e politikave të zbatueshme për sigurinë. Megjithatë, përmirësimi i kapacitetit operacional të BE-së kërkon iniciativë praktike, duke përfshirë investime të konsiderueshme në kapacitetet ushtarake dhe rritjen e shpenzimeve të mbrojtjes nga qeveritë e vendeve të saj. Së fundi, rezultati i luftës dhe kërcënimet hibride janë të gjera dhe të pasigurta të cilat rrisin urgjencën e zbatimit të iniciativave politike dhe pragmatike të paraqitura nga NATO dhe BE.

Tashmë duket qartë se në një periudhë të afërt, integrimi i thelluar i mbrojtjes midis Bashkimit Europian (BE) dhe NATO-s do të mbështesë modernizimin e aftësive dhe ndërveprueshmërinë, duke zgjeruar rrjetet europiane të prokurimit të pajisjeve. Dispozitat bashkëpunuese të sigurisë së Konceptit Strategjik të NATO-s 2022 dhe orientimet Strategjike të BE-së ofrojnë një kornizë praktike për forcimin e bashkëpunimit BE-NATO.

Koncepti Strategjik i NATO-s, Madrid 2022 njeh vlerën e aftësive të zgjeruara të mbrojtjes europiane të mbështetura nga ndërveprueshmëria BE-NATO. Hapat praktikë që mbështesin aftësitë ndërvepruese të mbrojtjes përfshijnë “iniciativat e politikave për të rritur shpenzimet e mbrojtjes dhe zhvillimin e aftësive koherente, reciproke përforcuese duke shmangur dyfishimet e panevojshme”. Investimet dhe bashkëpunimi në sistemet e aleancës mbështesin integrimin BE-NATO, eliminojnë tepricat e kapaciteteve dhe zvogëlojnë barrën e SHBA-së. Koncepti Strategjik dhe pozicioni Strategjik i BE-së trajtojnë mangësitë e politikave që kufizojnë pavarësinë e mbrojtjes europiane.

Gjithashtu, fusha e bashkëpunimit pas miratimit të Konceptit Strategjik të NATO-s ka sjellë ndryshime të ndjeshme të startuar në fushën e sigurisë dhe mbrojtjes në vendet aleate siç është edhe Shqipëria. Kërkesat strategjike bëjnë thirrje për rritjen e shpenzimeve të mbrojtjes të mbështetura nga partneritetet e zgjeruara politike dhe ushtarake. Shtetet anëtare të BE-së janë zotuar të rrisin shpenzimet e mbrojtjes dhe të promovojnë inovacionin teknik përmes investimeve të synuara. Zgjerimi ofron dy rrugë plotësuese për të forcuar bashkëpunimin BE-NATO. Së pari, për të përmirësuar koordinimin politik, BE-ja “do të organizojë takime të përbashkëta më të shpeshta dhe gjithëpërfshirëse të nivelit të lartë BE-NATO që fokusohen në çështje strategjike të rëndësishme” Përmirësimi i dialogut politik lejon partneritetin BE-NATO të përmirësojë komunikimin strategjik dhe të ndajë inteligjencën thelbësore. Së dyti, për të forcuar bashkëpunimin ushtarak, BE-ja kërkon të zgjerojë stërvitjet paralele dhe të koordinuara BE-NATO, duke



përfshirë stërvitje të përbashkëta dhe gjithëpërfshirëse. Këto përfshijnë diskutime të fokusuara në skenarë dhe lëvizshmëri ushtarake në stërvitjet e përbashkëta ushtarake, të cilat mbështesin ndërveprueshmërinë dhe me gjasë ndërtojnë besimin. Arritja e objektivave të mbrojtjes kolektive do të kërkojë rritjen e shpenzimeve të përgjithshme të BE-së për mbrojtjen. Shpenzimet e mbrojtjes BE-NATO për shumë vende nuk përbushin prapë prej 2% të PBB-së dhe shumë materiale në gamë të gjerë të shpenzimeve për pajisje, si pjesë e shpenzimeve të mbrojtjes. Shpenzimet e kufizuara të mbrojtjes kanë përsh-

pejtuar boshllëqet e aftësive. Europa varet “nga mbështetja e SHBA-së për mundësitë kritike si karburanti, transporti ajror strategjik, kapacitetet e zbulimit dhe inteligjencës”. Domosdoshmëria e mbështetjes materiale të SHBA-së gjatë gjithë luftës në Ukrainë dëshmon sërish rëndësinë e rritjes së shpenzimeve të përgjithshme të mbrojtjes së BE-së mbi prapë 2% të PBB-së dhe prioritizimin e kapërcimit të boshllëqeve të aftësive nëpërmjet rritjes së investimeve industriale. Në këtë kuadër sistemi i planifikimit të mbrojtjes tonë ka fokusuar çështjen sa politike dhe ushtarake që në vitin 2024 të arrijë nivelet e buxhetit të mbrojtjes në masën 2% të CDP.

Pra, sot duhet të veçojmë problematikën dhe të përfshihem në përparësitë e axhendave të prokurimit vendas në vend që të çojnë përpara një strategji të koordinuar me vendet aleate të NATO-s dhe BE-së për prokurimin e pajisjeve.

Në politikën e tyre eliminimi i tepricave përmes politikave të koordinuara të prokurimit do të kërkonte rritjen e bashkëpunimit politik BE-NATO dhe zgjerimin e bazës industriale të NATO-s. Pra, sot mjaft vende provojnë se baza industriale e partneritetit BE-NATO nuk duket se është në gjendje të plotësojë rezervat e armëve dhe të zëvendësojë aftësitë në mënyrë efikase. Më tej, mungesa e diversifikimit në burimet e lëndëve të para dhe prodhimi i pamjaftueshëm vendas i

komponentëve thelbësorë rrezikojnë reagimin strategjik të BE-së.

Kërkesa e Konceptit Strategjik të NATO - 2022 vë theksin te zhvillimi i bazës industriale që kërkon bashkëpunim politik BE-NATO dhe një aleancë transatlantike të forcuar. Kjo do të thotë se BE-ja “do të përmirësojë bashkëpunimin e vazhdueshëm për dialogun politik, zhvillimin e aftësive ushtarake dhe lëvizshmërinë ushtarake”. Për më tepër, përfshirja e një zgjerimi të bazës industriale në listën e prioritetëve të politikave reciproke do të lejonte partneritetin BE-NATO të avanconte perspektivën e pavarësisë së mbrojtjes europiane. Marrëdhënia dypalëshe BE-SHBA është gjithashtu thelbësore për projektin e autonomisë strategjike të Europës. Dialogu strategjik i zgjeruar në lidhje me shpenzimet e mbrojtjes dhe zhvillimin e bazës industriale do të mbështeste evolucionin e aleancës euro-atlantike.

Në deklaratën e përbashkët BE-NATO të vitit 2018, vendet anëtare mirëpritën marrëveshjet politike që i japin përparësi sigurisë dhe mbrojtjes në negociatat buxhetore. Gjuha e Konceptit Strategjik NATO - 2022 dhe prioritetet Strategjike kërkojnë rritjen e shpenzimeve të mbrojtjes dhe koordinimit strategjik, ku ne duhet të nxitojmë të pasqyrojmë kornizat konceptuale të parashikuara në dokumente të planifikimit por edhe të kërkesave të NATO-s.

Zbatimi praktik dhe i përbashkët i politikave do të kërkojë vullnet politik nga të gjithë qeveritë por edhe qeveria shqiptare e cila është përfshirë në shumë masa domethënëse në forcimin e sigurisë dhe mbrojtjes. Pa marrëveshje politike në lidhje me zgjerimin e bazës industriale, strategjitë e synuara të investimeve të dizajnuara për të kapërcyer boshllëqet e aftësive dhe politikave të prokurimit kolektiv, tepricat me shumë gjasa do të rrisin ndërveprueshmërinë dhe pavarësinë e sigurisë e vendit. Çështjet e trajtuara në këtë shkrim mbeten objekt i përhershëm për të reflektuar në shumë fusha të planifikimit strategjik të sigurisë dhe mbrojtjes. Në veçanti, ato do të jenë objekt studimi, rivlerësimi dhe referencë për rishikimin e dokumenteve madhore siç janë strategjia e sigurisë kombëtare, strategjia ushtarake, planet dhe programet e mbrojtjes afatmesme dhe afatgjata të cilat do të bëjnë të mundur të sjellin në nivelin e duhur edhe bashkëpunimin efektiv me aleatët dhe BE-në.



# Luftëtari ndërkombëtar Asim Vokshi

## (Në kuadrin e 85-vjetorit të rënies)



Prof. Asoc. Dr. BERNARD ZOTAJ

### Arsimimi i Asimit

Kishte dy vjet që zhvillohej Lufta e Parë Botërore dhe në janar të vitit 1916 ushtritë austro-hungareze, duke ndjekur forcat serbo-malazeze për qëllimet e tyre imperialiste, pushtuan pothuajse gjithë vendin. Pushtuesi i ri, për interesat e veta politike e për të lehtësuar mbajtjen e pushtimit, dha disa liri të pjesshme, lejoi hapjen e shkollave në gjuhën shqipe. Për tre vjet, nga 1916 deri më 1919, të pushtimit austro-hungarez, u hapën shkolla në gjuhën shqipe. Në shtëpinë e Vokshit, në shkollën e hapur, u mblodhën 925 fëmijë. Mësuesi i parë ishte Ibrahim Fehmiu. Shqiptari kishte luftuar edhe për shkollën, të mësonte gjuhën e tij, të bëhej më i ditur. Në qytetin e Gjakovës u hapën dy shkolla fillore gjashtë-klasëshe. Njerës iu vu emri i Heroit Kombëtar, “Skënderbeg”. Ishte viti 1916. Kjo ngjarje e madhe pati ndikim të fortë, si në çdo vatër kosovare, edhe në familjen e Vokshëve të Gjakovës. Më 17 tetor të vitit 1922 u hap shkolla e parë shqipe 6-vjeçare dhe me konvikt, nën kujdesin e Bajram Currit e shokëve të tij patriotë. Konvikti i shkollës në fillim ishte në Kolgecaj dhe më pas u vendos në Krumë.

Asim Vokshi në vitin shkollor 1926-1927 shkoi në një shkollë më të lartë, në gjimnazin shtetëror të qytetit të Shkodrës dhe u sistemua në konviktin “Malet tona”. Në vitin 1929, Asimi fitoi një bursë shtetërore për të studiuar në auditorët e Akademisë Ushtarake të Këmbësorisë, Kavalërisë dhe Shkollës së Aplikacionit të Këmbësorisë në Modena të Italisë. Studimet zgjatën për dy vjet, në harkun kohor 1929-1930 dhe 1930-1931. Së bashku me Asim Vokshin, në grupin (kursin) e tij, studionin edhe 37 djem të tjerë nga treva të ndryshme të Shqipërisë. Mes studentëve dhe oficerëve të Akademisë, ekzistonin dy rryma, njëra monarkiste dhe tjetra fashiste. Asimi arriti t’i njohë dhe i shfrytëzoi këto për të kuptuar drejt dhe thellë të vërtetën e shkollës që përgatiste ushtarakë të molepsur nga ideologjia fashiste, shtypës për popullin italian dhe mish për top për pushtimin e Shqipërisë e të popujve të tjerë.

### Detyrat ushtarake në Shqipëri

Studimet përfunduan në fund të vitit 1931 dhe, më 1 shtator të këtij viti Asimi, me gradën nëntoger, u kthye në Shqipëri dhe u emërua në



Pogradec në detyrën zëvendëskomandant i xhandarmërisë së rrethit. Brenda vitit Asimi u transferua përkohësisht adjutant i qarkut të xhandarmërisë në Gjirokastrë. Më gjatë se kudo Asimi shërbeu në Delvinë. Në korrik të vitit 1934, Asimi mori njoftimin për një transferim të ri. Këtë radhë në Tiranë, ikte nga baza dhe shkonte në qendër. Midis Shqipërisë dhe Italisë fashiste, gjatë vitit 1934, marrëdhëniet u acaruan së tepërmi. Roma e donte ta kishte sa më parë Shqipërinë koloni të plotë të saj. Ajo i bënte presion dhe e kërcënonte. Më 22 qershor dërgoi pa asnjë paralajmërim dhe leje 22 luftanije në portin e Durrësit. Këtë kërcënim e quajti vizitë “miqësore”. Gjithë politika e tij antikombëtare, e brendshme dhe e jashtme, ngjalli zemërim të thellë në radhët e popullit. Mbi këtë bazë, në rrethet përparimtare, që në pranverë të vitit 1934, u shtrua si detyrë e ditës organizimi i një kryengritjeje të armatosur kundër regjimit.

Qysh më parë, por sidomos gjatë viteve 1932-1935, ai u njoh dhe u lidh me udhëheqës të së majtës në Shqipëri dhe jashtë saj. Madje, në Tiranë ai krijoi dhe kryesonte një organizatë të njohur në historinë e Shqipërisë me emrin “Grupi Komunist i Oficerëve”. Në këtë grup bënin pjesë shumë ushta-

rakë shqiptarë, mes tyre disa shumë të njohur si Bedri Spahiu, Tahir Kadare, Hulusi Spahiu, Dali Ndreu, Prenk Uli, Veli Dedi, etj. Asim Vokshi ishte ndër organizatorët e Kryengritjes së Fierit të vitit 1935, në prag të së cilës u arrestua dhe u dënua me burgim.

### Luftëtar dhe komandant në Spanjë

Kur fashistët goditën pabesisht Republikën Spanjolle ai u inkadrua në rreshtat e Brigadës Internacionale “Garibaldi” si ushtar i thjeshtë. Grupi i oficerëve ishte nismëtari dhe dërgoi për të marrë pjesë në Luftën e Spanjës të viteve 1936-1939.

Zotësia që tregonte Asimi në fushën e betejës, përfundimet që nxirrte nga veprimi edhe i ushtarit të thjeshtë, këshillat dhe ndihma për shokët, shumë shpejt i bindën luftëtarët e batalionit të tretë, të Brigadës “Garibaldi” se kishin të bënin me një njeri që njihte luftën dhe armët e saj, njeri që kishte të bashkuara mirë shpirtin e papërkulur me mjeshtërinë e përdorimit të armëve. Ata kishin vënë re se Asimi hidhej në zjarrin e betejave i papërmbytur, dhe kjo ua rriste moralin shokëve, që të mos i lëshonin llogoret e luftës. Asimi fliste rrallë dhe ashtu i heshtur, më tepër dëgjonte. Shembulli i tij personal në sulm u bë mjet edukues për të tjerët

dhe lavdi për popullin shqiptar, që e përfaqësonte denjësisht në arenën luftarake ndërkombëtare. Ai u tregua i pjekur, luftëtar i papërkulur kundër fashizmit dhe mjeshtër i armës.

Kur nisnin betejat, komandanti i ngarkonte Asim Vokshit detyrat më të vështira. Ata dhe shokët e tij kishin besim te ai, se ishte ushtar me disiplinë të hekurt i asaj ushtrie, ku merrnin pjesë luftëtarë nga pesëdhjetë e tre kombe, zbatonte urdhrat dhe e plotësonte detyrën deri në fund. Asimi i kryente detyrat, mbasi njihte artin e luftës, dinte të përdorte me mjeshtëri armët, kishte guxim dhe ishte gjakftohtë.

Kështu, në mes të njëqind e njëzet luftëtarëve, aq sa kishte një kompani, komandant u bë Asim Vokshi. Ai përherë ishte shquar në cilësitë e mrekullueshme për të komunikuar shpejt me njerëzit, me shokët, për t’ua fituar atyre besimin dhe dashurinë. Por më shumë se kudo, kjo duhej bërë në fushën e betejës, me shokët e luftës. I deshi luftëtarët e kombësive të ndryshme, të cilët po aq e deshën, si vëlla, si luftëtar, si komandant. Te komandanti shqiptar ata kishin besim të pakufi, sepse ai ishte i sakrificës, jepte gjithçka për shokun e luftës. Ku ishte rreziku më i madh, aty gjendej me parë komandanti. Aq i ëmbël ishte në

pushim, aq i egër bëhej në vijën e zjarrit, kur shënonte në llogoret e armikut.

Asim Vokshi, si ushtarak i talentuar, kishte bërë emër në brigadën “Garibaldi”. Duke njohur aftësitë e tij organizuese dhe përgatitjen e lartë si ushtarak, u thirr në shtatmadhori, e cila e caktoi në shtabin e Brigadës “Garibaldi” oficer të shtabit, për të dhënë edhe ai mendime e për të marrë pjesë në diskutimin e çështje të ndryshme të organizimit të trupave e të luftimit. Në mendimin e komandës së brigadës, Asim Vokshi ishte tashmë një ushtarak i pjekur, luftëtar i vendosur e besnik dhe kishte perspektivë për një detyrë më të rëndësishme, komandant kompanie në batalionin e tretë të Brigadës së 12-të “Garibaldi”.

Në fund të gushtit të vitit 1937, republikanët kaluan në mësymje në frontin e Aragonit në drejtim të Saragozës, me qëllim që të tërhiqnin vëmendjen e komandës fashiste, e cila ishte hedhur me forcat kryesore në frontin e veriut, duke kërcënuar qytetin e Santanderit në tokën baske. Veprimet luftarake ishin shumë të ashpra e të përgjakshme, të cilat në këtë front, vazhduan deri më tej nga gjysma e muajit tetor. Asimi mori pjesë në luftimet e ashpra të Fuento del Ebros, ku ra dëshmor, në luftimet e datës 4 tetor të vitit 1937, kur ishte vetëm 27 vjeçar.

Në korrik të vitit 1943, vëllai i dytë i Asimit, Derguti, u pushkatua nga fashistët italianë, në Landrovicë të Gjakovës. Halla, Bije Vokshi i tregon të vërtetën të vëllait, Aliut, babait të Asimit: “Të rrosh vetë vëlla, Dergutin e vranë sot fashistët italianë, Asimin e kanë vra para gjashtë vjetësh në Spanjë!”.

### Në memorie të popullit shqiptar, kosovar dhe spanjoll

Asim Vokshi, Heroi i Popullit nuk ka varr. Populli, këtij biri të vet të pavdekshëm, në vend të varrit, i ka ngritur monumente bronz, i ka thurur këngë, shumë shkolla dhe rrugë mbajnë emrin e tij, si dhe janë shkruar libra dhe monografi për jetën e tij. Për meritat e tij revolucionare në luftën për lirinë e Atdheut është dekoruar me Urdhrin e Skënderbeut të Klasit të II-të dhe më 10 korrik 1949 Kuvendi Popullor i dha titullin e lartë “Hero i Popullit”.

Asim Vokshi është çmuar dhe dekoruar nga shteti spanjoll në nderim të veprës së tij si dëshmor. Monumente janë ngritur në brigjet e Ebros së përgjakur. Dita e madhe e lirisë është mbjellë cep më cep në të gjithë tokën spanjolle. Në të gjitha betejat më të ashpra, sidomos ato të Madridit, Haramës, Guadalajarës, Brunetës, Teruelit, Aragonit, Ebros dhe Katalonjës morën pjesë edhe vullnetarët shqiptarë, të cilët nuk mbetën aspak prapa trimave më të mirë të Luftës së Spanjës. Populli spanjoll kurrë si ka harruar luftëtarët ndërkombëtarë që u vranë për lirinë e tij.

Përshtati: MIMOZA GOLIKJA

Kryetari i Komitetit Ushtarak të NATO-s, admiral Rob Bauer në vizitën e tij në Serbi u takua me Presidentin serb Aleksandar Vučić, ministrin e Mbrojtjes, Miloš Vučević, ministrin e Punëve të Jashtme, Ivica Dacic, ushtrues detyre, ministrin e Politikës së Mbrojtjes, Predrag Bandić dhe shefin e Mbrojtjes, gjeneral Milan Mojsilović. Ai vizitoi Zyrën e Ndërlidhjes Ushtarake të NATO-s dhe mbajti një leksion në Akademinë Ushtarake të Universitetit të Mbrojtjes. Gjatë gjithë vizitës, admiral Bauer shoqërohej nga koloneli Milan Ranković, përfaqësues ushtarak serb dhe shef i misionit në NATO.

Në takimin e tij me shefin e mbrojtjes, admiral Bauer përsëriti respektin e NATO-s për politikën e neutralitetit ushtarak të Serbisë, ndërsa theksoi përfitimet reciproke që kanë rezultuar nga bashkëpunimi i vazhdueshëm NATO-Serbi. “Qëllimi i vizitës sime është të diskutoj se si NATO dhe Serbia mund të vazhdojnë të punojnë së bashku për të forcuar aftësitë e Forcave të saj të Armatosura. Gjatë gjashtëmbëdhjetë viteve të fundit, ne e kemi ndihmuar Serbinë të reformojë forcat dhe institucionet e saj të sigurisë, duke rritur ndërveprimin me trupat aleate dhe duke forcuar kapacitetet e Forcave të Armatosura Serbe. Kemi shumë për të fituar dhe për të mësuar nga njëri-tjetri”, - shtoi ai.

Admirali Bauer u takua me ushtruesin e detyrës së ndihmës ministrit të Politikës së Mbrojtjes, Predrag Bandić, ku diskutuan situatën aktuale të sigurisë në Ballkanin Perëndimor dhe rritjen e aktiviteteve me qëllim të keq, si sulmet kibernetike, hakerimet, dezinformatat, frikësimet dhe aktivitete të tjera destabilizuese. “Ballkani Perëndimor është një rajon me rëndësi strategjike. Në të gjithë Ballkanin Perëndimor, NATO ka tre synime kryesore: forcimin e stabilitetit, rritjen e qëndrueshmërisë dhe ndërtimin e një bashkëpunimi më të madh. Bashkëpunimi NATO-Serbi rrit sigurinë e Serbisë si dhe të NATO-s. Të gjithë së bashku po punojmë për të ruajtur paqen dhe prosperitetin për qytetarët tanë”, - theksoi admiral Bauer.

Në takimin me Presidentin Aleksandar Vučić, admiral Bauer vuri në dukje rolin e rëndësishëm dhe stabilizues që Serbia po luan në rajon. “NATO respekton plotësisht politikën e neutralitetit ushtarak të Serbisë. Partneriteti që kemi ndërtuar gjatë gjashtëmbëdhjetë viteve të fundit bazohet në kërkesën e Serbisë. Është përshtatur për nevojat e Serbisë dhe është reciprokisht e dobishme. Bashkëpunimi NATO-Serbi bazohet në forcën dhe respektin reciprok”. Takimit iu bashkua edhe ministri i sapemëruar i Mbrojtjes, Millosh Vučević.

Admirali Bauer ishte gjithashtu në Akademinë Ushtarake të Universitetit të Mbrojtjes, ku foli për partneritetin NATO-Serbi në këtë epokë të re për sigurinë globale. “Forcat e armatosura janë një nga shtyllat kryesore të shtetit. Nuk ka detyrë më fiskale se mbrojtja e atdheut. Bashkëpunimi ndërmjet NATO-s dhe Serbisë synon të arrijë pikërisht këtë, të forcojë sigurinë e Serbisë. Siguria është një përpjekje në ekip dhe kërkon marrëdhënie dhe partneritete të forta”.

Më 3 dhe 4 nëntor, Forumi Ministror BE-Ballkani Perëndimor për Drejtësinë dhe Çështjet e Brendshme, që do të mbahet në Tiranë, do të diskutojë rrugën e përbashkët përpara në fushën e drejtësisë, migracionit dhe sigurisë. Ylva Johansson, Komisionerja për Punët e Brendshme, do të marrë pjesë në takimin e Ministrave të Punëve të Brendshme; dhe, Didier Reynders, Komisioneri për Drejtësinë, do të marrin pjesë në takimin e Ministrave të Drejtësisë. Më 3 nëntor, takimet e “Punëve të Brendshme” do të fillojnë duke trajtuar çështjet e sigurisë pas agresionit të pajustificuar të Rusisë kundër Ukrainës. Komisioneri Johansson do të diskutojë me ministrat e brendshëm zhvillimet më të fundit në migracionin, azilin dhe menaxhimin e kufirit. Diskutimet do të bazohen në Qasjen e Përbashkët për Migracionin e propozuar nga Komisioneri Johansson me partnerët e Ballkanit Perëndimor gjatë Procesit të Pragës më 24 tetor dhe takimit të Procesit të Berlinit më 20 tetor. Në takime do të marrin pjesë edhe Europol, Frontex dhe Agjencia e Bashkimit European për Azilin. Një konferencë për shtyp do të pasojë në EbS. Më 4 nëntor, Komisioneri Reynders do të marrë pjesë në takimin e ministrave të drejtësisë, duke nisur me diskutimin për shtetin e së drejtës në Bashkimin European dhe në Ballkanin Perëndimor. Komisioneri Reynders do të shkëmbejë mendime mbi ndjekjen penale të krimit të organizuar dhe korrupsionit. Më pas pjesëmarrësit do të diskutojnë masat e marra kundër luftës së agresionit të zhvilluar nga Rusia kundër Ukrainës. Komisioneri Reynders do të japë një përditësim mbi aktivitetet e grupit të punës Freeze and Sixteen dhe nismat e fundit për të kriminalizuar shkeljen e sanksioneve të BE-së, të miratuara në maj 2022. Komisioneri do të ndajë gjithashtu shqetësimet e tij në lidhje me programet e shtetësisë për investim të zbatuara nga disa perëndimore Partnerët ballkanikë.

# KËRKIMET USHTARAKE DHE PËRGJEGJËSIA SHOQËRORE E SHKENCËTARËVE

**K**ërkimi shkencor dhe përparimi teknologjik janë historikisht të lidhura gjithashtu me luftën: një pjesë thelbësore e kërkimit, në fakt, kryhet sot për qëllime ushtarake dhe po bëhet gjithnjë e më e vështirë ndarja e teknologjive të përdorimit ekskluzivisht civil. Lidhja me industrinë ushtarake kontribuon pjesërisht në prestigjin dhe financimin e kërkimit, por padyshim rrezikon ta vërë atë në kundërshtim me qëllimin e saj kryesor: përparimin njerëzor.

Kjo situatë, së bashku me pasojat njerëzore dhe mjedisore të zhvillimit të pakontrolluar, kanë shkatërruar imazhin publik të shkencës dhe do të ishte e rëndësishme që të mund të ndryshonim këtë prirje. Nga njëra anë, shoqëria civile duhet të shmangë reagimet obskurantiste të denigrimit dhe braktisjes së kërkimit shkencor, duke ëndërruar për kthimin në një “epokë të artë” mitike, apo duke e braktisur veten në ngushëllimin që ofron përkatësia në grupe sektare; nga ana tjetër, komuniteti shkencor nuk duhet të mbyllet - nga cinizmi apo interesi - në kullën e fildishtë të një shkence neutrale, thjesht duke bërë dallimin midis kërkimit dhe përdorimit të tij, por duhet të vërë në dyshim funksionin e tij civil për të rimarrë pikërisht rolin që ka. Kontrolli i kërkimit, pa mbytur krijimtarinë e tij, mbetet një ekuilibër i vështirë: shpikja e armëve të shkatërrimit në masë dhe përmirësimi i armëve konvencionale, megjithatë, e kanë bërë këtë dilemë me rëndësi dramatike. Përgjigja mund të fillojë vetëm me shpërndarjen, mes qytetarëve, të informacionit të kualifikuar dhe të balancuar, por edhe mbi të gjitha mes atyre që vendosin. Ky ndërgjegjësim ka nxitur një rol aktiv të shkencëtarëve dhe shoqatave të tyre, me besimin se përparimi i qytetërimit shkon paralelisht me përparimin e dijes. Debat i përparimit moral dhe civil të shkencëtarëve nuk është i ri, edhe pse në pesëdhjetë vitet e fundit ai ka marrë një peshë tjetër. Para së gjithash, dikush pyet nëse shkencëtarët kanë të drejtë të kryejnë kërkime që dëmtojnë njerëzimin: në një periudhë pas shpikjes së armëve bërthamore, në fakt, efektet e dobishme të kërkimit shkencor dukej se kompensoheshin edhe nga efektet e tij negative. Ndonjëherë këto janë të paqëllimshme - siç është rasti me pasojat shëndetësore dhe mjedisore të zhvillimit të pakontrolluar ekonomik, por sigurisht që nuk është rasti për ndërtimin e atyre që janë njohur si Armët e Shkatërrimit në masë (ADM: kimike, biologjike dhe bërthamore armë). Në rastin e dytë, lind problemi i një përdorimi të ndërgjegjshëm dhe negativ të njohurive shkencore.



Foto: NATO

## A mund të mbahen përgjegjës shkencëtarët për këto zhvillime?

Përtej përgjegjësiave personale të atyre që marrin pjesë drejtpërdrejt në programet kërkimore të luftës, është e dukshme se pyetja mund t'i drejtohet të gjithë kategorisë së studiuesve shkencorë, duke qenë se ndonjëherë pasojat e zbulimeve i tejkalojnë jo vetëm qëllimet, por edhe përdorimet e parashikueshme. Nga ana tjetër, përballë këtyre pyetjeve, shkencëtari munda vetëm të braktiste kërkimin duke na privuar nga përfitimet e tij, ndërsa paralajmërimi i qeverive dhe komandave ushtarake për rrezikun e mjeteve që u vihen në dispozicion duket një detyrë e vështirë dhe e destinuar të mos jetë shumë e suksesshme...

Një nga pasojat më të rrezikshme të kësaj situatë të bllokuar është rritja në opinionin publik, e një qëndrimi negativ ndaj shkencës: një fakt që në shumë mënyra është tashmë aty për ta parë të gjithë, por që thjesht nuk është i pranueshëm nëse duam të përparojmë qytetërimin tonë pa ëndërruar kthimin në epokë mitike të pa ndotura nga një gjoja arrogancë shkencore. Në një farë mënyre, duke pasur parasysh edhe nivelin e zhvillimit demografik, ne tani jemi të destinuar të bashkëjetojmë me shkencën

dhe teknologjinë, të cilat janë bërë edhe motorë të zhvillimit ekonomik.

Nga një këndvështrim tjetër, ai i studiuesve, shkenca sot është kthyer në një profesion, një profesion si shumë të tjerë; një profesion, në veçanti, që varet shumë nga financimi publik dhe kërkimi ushtarak është një nga më të financuarit nga qeveritë. Nga ana tjetër, duhet mbajtur mend se mbrojtja është një nga përgjegjësitë kryesore të institucionit shtetëror, kështu që në një farë kuptimi ky theks i vendosur në gjetjen e mjeteve më të përshtatshme për ta arritur atë nuk është i papërshtatshëm. Vështirësitë lindin më tepër nga fakti se kufiri midis mbrojtjes dhe sulmit nuk është aq i saktë, siç e dimë mirë në një periudhë ndërhyrjesh parandaluese, dhe nga fakti, po aq i dukshëm sot, se vetë përdorimi i disa armëve - si p.sh. të ashtuquajturat Armët e Shkatërrimit në masë (ADM) - paraqet probleme serioze morale.

Në këtë kuptim, qeveritë janë kryesisht përgjegjëse për zhvillimin e kërkimeve për qëllime lufte dhe padyshim një nga aspektet më delikate dhe vendimtare të gjithë çështjes është pikërisht mundësia për të ndikuar në vendimet e tyre në lidhje me këto fonde. Është pikërisht këtu që një formë kontrolli mbi zgjedhjet dhe drejtimit e kërkimit

është e nevojshme dhe gjithashtu, në një farë mase, e mundur për të parandaluar që shkenca të prodhojë efekte të padëshiruara nga shkencëtarët. Sigurisht që është e dobishme që qëndrime të tilla të merren jo nga individë, por nga grupe të ndjeshme ndaj këtyre problemeve. Por edhe më drastikisht, duke pasur parasysh se ndonjëherë pasojat negative të rezultateve të kërkimit nuk janë as të qëllimshme, mund të shtrohet pyetja nëse shkencëtarët kanë të drejtë të bëjnë kërkime që nuk janë me siguri të përdorimit të dobishëm. Në realitet, nëse përgjigja do të ishte negative, edhe kërkimi i pastër do të duhej të parandalohej: aplikimet mund të zgjasin shumë për t'u shfaqur, dhe një qëndrim i ngurtë ndaj këtyre problemeve do të çonte në mënyrë të pashmangshme në dënimin e shumicës së aktiviteteve shkencore. Njohuria e pastër është po aq e rëndësishme sa njohuritë e aplikuara, dhe gjithashtu ndonjëherë shpikjet e dobishme mund të kenë gjithashtu efekte negative: thjesht mendoni për afërsinë teknologjike midis pesticideve dhe defoliantëve nga njëra anë dhe armëve të vërteta kimike nga ana tjetër.

## Çfarë duhet bërë atëherë?

Duhet të garantohet liria e kërkimit, e cila mbetet një nga motorët e



SHOQËRIA CIVILE DUHET TË SHMANGË REAGIMET OBSKURANTISTE TË DENIGRIMIT DHE BRAKTISJES SË KËRKIMIT SHKENCOR, DUKE ËNDËRRUAR PËR KTHIMIN NË NJË “EPOKË TË ARTË” MITIKE, APO DUKE E BRAKTISUR VETEN NË NGUSHËLLIMIN QË OFRON PËRKATËSIA NË GRUPE SEKTARE; NGA ANA TJETËR, KOMUNITETI SHKENCOR NUK DUHET TË MBYLLET - NGA CINIZMI APO INTERESI - NË KULLËN E FILDISHTË TË NJË SHKENCE NEUTRALE, THJESHT DUKE BËRË DALLIMIN MIDIS KËRKIMIT DHE PËRDORIMIT TË TIJ, POR DUHET TË VËRË NË DYSHIM FUNKSIONIN E TIJ CIVIL PËR TË RIMARRË PIKËRISHT ROLIN QË KA.

avancimit shkencor, por në të njëjtën kohë shkencëtarët, si individë dhe si komunitet, nuk mund ta përjashtojnë veten nga barra e monitorimit të pasojave të punës së tyre. Për këtë arsye, ndonjëherë dëgjojmë për propozimin për të krijuar një Betim Hipokrati për fizikën (ose shkencat e tjera), megjithëse shumë janë skeptikë për efektivitetin e një dispozite të tillë. Të tjerë propozojnë në vend të kësaj ngritjen e një këshilli publik shkencëtarësh dhe politikanësh për të gjykuar kërkimin, i cili megjithatë do të rrezikonte të krijonte vetëm një barrë shtesë burokratike pa rezultate të dukshme. Natyrisht, këto probleme nuk kufizohen vetëm në fizikë, megjithëse shpikja e armëve bërthamore i ka dhënë kësaj shkencë një lehtësim dhe prestigj që nuk e kishte pasur kurrë më parë. Prandaj, në një farë kuptimi, mund ta marrim si të mirëqenë, ndërgjegjësimin për përgjegjësitë që kanë fizikanët në kryerjen e punës së tyre dhe të kufizohemi në dhënien e disa shembujve të faktit se në këto probleme përfshihen edhe sektorë të tjerë shkencorë.

Edhe fusha e matematikës, e cila në pamje të parë mund të duket e imunizuar, është e përfshirë qartë: pa kujtuar kontributin e madh të matematikanëve (nga John von Neumann te Stanislaw Ulam) në



USHTRIA DO TË JETË NË GJENDJE TË MARRË KOMANDA NËPËRMJET ELEKTRODAVE TË IMPLANTUARA NË TRU. ATO GJITHASHTU MUND TË LIDHEN DREJTPËRDREJT ME PAJISJET QË ATA KONTROLLOJNË”. INTERESI I DARPA-S PËR NEUROSHKENCËN DATON QË NË VITET 1990 DHE KËTO JANË AKTIVITETE NË KONKURRENCË ME ATO TË NIH (INSTITUTI KOMBËTAR I SHËNDETIT), I CILI NË PËRGJITHËSI ËSHTË MË TRADICIONAL DHE MË I KUJDESSHËM. PËRGJIGJET E SHKENCËTARËVE, QË MORËN ANËN NË MBROJTJE TË KËRKIMIT TË FINANCUAR NGA DARPA, JANË MJAFT KLASIKE: PROBLEMI LIND NGA PËRDORIMI I KËTYRE TEKNOLOGJIVE DHE JO NGA TEKNOLOGJITË SI TË TILLA; NËSE USHTRIA KONTROLLOHET MIRË NUK KA PROBLEME; VETËM APLIKACIONET JANË TË MIRA OSE TË KËQIJA.

Projektin Manhattan, do të mjaftojë të përmendim faktin se Norbert Wiener në 1946 shkroi një letër, e bërë më vonë publike, për të nënvizuar arsyet me të cilat ai kishte refuzuar t'i vinte në dispozicion punën e tij të veçantë shkencore një kolegu që e kishte kërkuar.

Ishte një artikull mbi kontrollin e raketave në fluturim që ishte shkruar gjatë luftës dhe për të cilin Wiener mendonte se duhej të kufizonte qarkullimin në kohë paqeje, edhe për shkak të pamundësisë së verifikimit të përdorimit të tij.

Natyrisht ai ishte plotësisht i vetëdijshëm për faktin se ky qëndrim i tij i shtronte studiuesit një tjetër nga dilemat tipike të epokës sonë. Publiciteti i kërimit shkencor është në njëfarë kuptimi i domosdoshëm për studiuesin e vërtetë: shkenca e vërtetë lind vetëm nga qarkullimi, krahasimi dhe përhapja e ideve. Megjithatë, Wiener pyet veten nëse është moralisht e justifikuar të shpërndahet ndonjë rezultat. Nga ana tjetër, edhe nëse në kuptimin diametralisht të kundërt, sot problemi i reklamës kërmore është bërë serioz: ai shrohet nga kërkesat për fshehtësi të vendosura nga financuesit si për arsye sigurie (në rastin e kërimeve ushtarake) ashtu edhe për qëllime tregtare (në rastin e kërimit industrial). Është e qartë se ky është një ekuilibër delikat: publiciteti i kërimit është thelbësor, por rrezikohet nga kërkesa për konfidencialitet e bërë nga financuesit ushtarakë dhe industrialë (dhe këtu në përgjithësi shkencëtari do të donte të mos e plotësonte këtë kërkesë), ndërsa nga ana tjetër, ndonjëherë vetë shkencëtari do të duhej të pozicionohej, duke përdorur fjalët e

vetë Wiener-it, si një censurues të vetvetes për arsye etike.

Një shembull tjetër i rëndësishëm mund të merret nga bota e kimisë: Fritz Haber, një kimist i rëndësishëm gjerman me origjinë hebreje, fitoi çmimin Nobel për kiminë në vitin 1918 për sintezën e amoniakut (1909), një zbulim që hapi rrugën për prodhimin e masë e plehrave kimike, dhe për rrjedhojë në një rritje dramatike të prodhimit të ushqimit me pasojat dukshme të dobishme për miliardë burra. Pasojat tregtare ishin gjithashtu shumë të mëdha dhe pasuria e BASF (Badische Soda und Anilin Fabrik) bazohet pjesërisht në shfrytëzimin e atij zbulimi.

● *Duhet të garantohet liria e kërimit, e cila mbetet një nga motorët e avancimit shkencor, por në të njëjtën kohë shkencëtarët, si individë dhe si komunitet, nuk mund ta përjashtojnë veten nga barra e monitorimit të pasojave të punës së tyre. Për këtë arsye, ndonjëherë dëgjojmë për propozimin për të krijuar një Betim Hipokrati për fizikën (ose shkencat e tjera), megjithëse shumë janë skeptikë për efektivitetin e një dispozite të tillë. Të tjerë propozojnë në vend të kësaj ngritjen e një këshilli publik shkencëtarësh dhe politikanësh për të gjykuar kërkimin, i cili megjithatë do të rrezikonte të krijonte vetëm një barrë shtesë burokratike pa rezultate të dukshme.*

Duke lënë mënjanë faktin se sot jemi të vetëdijshëm për rreziqet e qenësishme të përdorimit pa kriter të plehrave, këtu duhet theksuar se nitratet e prodhuara me metodat e reja kishin një përdorim shumë të rëndësishëm edhe për prodhimin e lëndëve plasëse: një mundësi që ishte plotësisht e shfrytëzuar nga Gjermania gjatë Luftës së Parë

Botërore, për të qenë në gjendje të zgjasë përpjekjet e saj luftarake.

Por bashkëpunimi i Haberit me ushtrinë nuk u ndal me kaq: ai luajti një rol udhëheqës në prodhimin e armëve të para kimike (të përdorura siç njihet gjatë Luftës së Madhe) dhe në planifikimin e përdorimit të tyre. Atdhetar i bindur, Haber nuk është penduar kurrë për këto aktivitete dhe përbën një shembull të fortë të zgjedhjeve që një shkencëtar duhet të bëjë në ushtrimin e profesionit të tij. Por historia ende i rezervoi Haberit disa surpriza tragjike, edhe nëse ai nuk kishte si ta kuptonte, pasi kishte vdekur në vitin 1934. Pas përfundimit të Luftës Botërore, ai e ktheu interesin e tij drejt pesticideve:

një nga preparatet më efektive nga preparatet e reja quhej Zyklon. B. Sigurisht që vetë Haber do të ishte të paktën i befashuar nga fakti se kjo është pikërisht substanca që u përdor masivisht që nga viti 1943 në Aushvic dhe Oranienburg për të shfarosur hebrenjtë e tjerë.

Kohët e fundit, kërkitimi, gjithashtu me interes ushtarak, i ka kthyer

interesat e tij në sektorë të rinj: bioteknologji, inxhinieri gjenetike, neuroinxhinieri. Dhe si zakonisht, edhe në këtë rast, ekziston një ndërthurje e ngushtë midis shkencës dhe tregut, midis interesave tregtare dhe dobisë shoqërore, midis kërimit të pastër dhe kërimit ushtarak. Është udhëzuese në këtë drejtim të raportohet një debat që u zhvillua në vitin 2003 në revistën “Nature”.

Në SHBA një pjesë e konsiderueshme e neuroinxhinierisë financohet nga Agjencia e Projekteve Kërkimore të Avancuara të Mbrojtjes (DARPA5) dhe këto kërkime kanë përdorime të mundshme ushtarake: cili është pozicioni i shkencëtarëve që punojnë atje?

Shpesh ata nuk duan të flasin për këtë dhe kufizohen në nxjerrjen në pah të përfitimeve të pamohueshme për mjekësinë që mund të sjellë puna e tyre. Hulumtimi në fjalë është një projekt dyvjeçar DARPA për 24 milionë dollarë amerikanë që përfshin matematikanë, biologë, inxhinierë materialesh: përfshin zhvillimin e teknologjive për bash-

kimin e trurit/makinës.

Ndërsa rezultatet mund të aplikohen në ndërtimin e gjymtyrëve artificiale për njerëzit me aftësi të kufizuara fizike të konsiderueshme, është gjithashtu e qartë se DARPA është e interesuar të krijojë “sisteme që mund të transferojnë mesazhe, të tilla si imazhe dhe tinguj, midis trurit të njeriut dhe makinerive”, ose edhe mes qenieve njerëzore.

Në perspektivë, ushtria do të jetë në gjendje të marrë komanda nëpërmjet elektrodave të implantuara në tru. Ato gjithashtu mund të lidhen drejtpërdrejt me pajisjet që ata kontrollojnë”. Interesi i DARPA-s për neuroshkencën daton që në vitet 1990 dhe këto janë aktivitete në konkurrencë me ato të NIH (Instituti Kombëtar i Shëndetit), i cili në përgjithësi është më tradicional dhe më i kujdesshëm. Përgjigjet e shkencëtarëve, që morën anën në mbrojtje të kërimit të financuar nga DARPA, janë mjaft klasike: problemi lind nga përdorimi i këtyre teknologjive dhe jo nga teknologjitë si të tilla; nëse ushtria kontrollohet mirë nuk ka probleme; vetëm aplikacionet janë të mira ose të këqija. Në fund të fundit, duhet të kujtojmë se interneti ka lindur në kuadrin e ARPA-net, paraardhësi i DARPA. Agjencia, për më tepër, financon kryesisht kërkimet bazë, të publikuara (jo sekrete), të kryera në universitete me theks të veçantë në materialet e reja, kompjuterët dhe inxhinierinë. Ai gjithashtu mbështet kërkime me rrezik të lartë, domethënë me rezultate të pasigurta: një aktivitet që kompanitë e tjera private do ta shmangnin.

# Tre nëntor 1443, epopeja e lavdisë së Skënderbeut

Shqiptarët e vazhduan luftën kundër pushtuesve osmanë në forma të ndryshme edhe pas kryengritjeve të viteve '30 të shek. XV. Nëpër dokumente të gjysmës së dytë të viteve '30 dhe fillimit të viteve '40 përmenden në viset shqiptare spahinj të vrarë, spahinj që, për të shpëtuar kokën, kishin braktisur timaret etj. Qëndresa e përhershme kundër pushtuesve osmanë dhe rrethanat e favorshme ndërkombëtare që u krijuan në fund të viteve '30 e në fillim të viteve '40 të shek. XV nxitën disa nga fisnikët shqiptarë të ngriheshin në luftë kundër pushtuesve të huaj.

Ndërkaq, në jetën kishtarë e politike të Shqipërisë ndikuan pozitivisht vendimet e Koncilit të Ferrarës, që u mbajt gjatë viteve 1438-1439. Krahës papë Eugjenit IV, në të morën pjesë edhe përfaqësuesit më të lartë të universit ortodoks, si perandori i Bizantit, Johan Paleologu, patriarku i Kostandinopojës, Jozefi, dhe peshkopët bizantinë e sllavë më në zë. Në korrik të vitit 1439 përfaqësuesit e të dy palëve nënshkruan tekstin e bashkimit shpirtëror të të dy kishave nën supremacinë e Papatit. Ky vendim ndikonte pozitivisht për zbutjen e mosmarrëveshjeve ndërmjet kishave ortodokse e katolike në Shqipëri dhe për rritjen e bashkëpunimit ndërmjet sundimtarëve shqiptarë të besimit katolik dhe ortodoks, si dhe të këtyre me forcat politike të huaja. Vendimet e Koncilit të Ferrarës ndihmonin bashkëpunimin ndërmjet vendeve europiane, që politikisht ishin shumë të copëtuara e të përçara, në luftën kundër armikut të përbashkët, pushtuesve osmanë, luftë që filloi të propagandohej si një kryqëzatë e të krishterëve kundër pushtuesve aziatikë e besimit të tyre islam.

Në fillim të viteve '40 të shek. XV, rrethanat ndërkombëtare favorizonin shpërthimin e kryengritjeve anti-osmane në Shqipëri. Me vendosjen në fronin e Hungarisë të mbretit të Polonisë, Vladislavit, trupat hungareze, të komanduara nga vojvoda i Transilvanisë, Janosh Huniadi, kaluan nga veprimet mbrojtëse në mësymje dhe përkohësisht arritën të ndalnin përparimin e osmanëve drejt Europës Qendrore. Pasi grumbulloi një ushtri të fuqishme, të përbërë prej hungarezësh, polakësh, rumunësh etj., J. Huniadi kaloi Danubin, u fut në thellësi të Ballkanit dhe në shtator të vitit 1442 u shkaktoi një disfatë të rëndë trupave osmane. Fitorja e ushtrisë së J. Huniadit ngjalli shpresa te popujt e shtypur të Ballkanit, nxiti lidhjet e sundimtarëve ballkanas me Hungarinë e me forca të tjera politike të kohës për zgjerimin e frontit të



luftës anti-osmane. Aktivisht veproi në këtë drejtim papa Eugjeni IV, i cili nëpërmjet peshkopëve të vet nxiste elitën drejtuese shqiptare e ballkanike të rrëmbente armët kundër osmanëve sapo trupat e J. Huniadit të marshonin sërish në drejtim të Ballkanit Qendror.

Këtë situatë ndërkombëtare disa fisnikë shqiptarë, midis tyre edhe Gjergj Arianiti, e vlerësuan të përshtatshme për fillimin e luftës. Në kuadrin e përgatitjeve Gjergj Arianiti forcoi lidhjet me vendet e tjera, duke dërguar përfaqësuesit e vet në Romë e në Bosnjë. Në gusht të vitit 1443 ai siguroi qytetarinë e Raguzës, që të strehohej familjarisht në atë qytet po që se do thyhej prej trupave osmane.

Në shtator të vitit 1443 Gjergj Arianiti sulmoi forcat osmane në lindje të zotërimeve të tij dhe i dëboi pushtuesit nga shumë krahina të Shqipërisë Qendrore. Fitoret e tij ndikuan në jetën politike të Shqipërisë dhe patën jehonë edhe në vendet e tjera. Vetë ai vazhonte përgatitjet për vijimin e luftës kundër osmanëve. Më 21 tetor përfaqësuesit e tij, sipas porosisë që kishin bërë në Raguzë, morën këtu flamurin e Arianitëve, që t'u printe luftëtarëve të tij në betejat e ardhshme. Në fund të muajit nëntor Gjergj Arianiti i kërkoi Raguzës t'i shiste bombardat, armë këto që i duheshin për çlirimin e kështjellave.

Lufta çlirimtare u përhap edhe në trevat e Shqipërisë së Poshtme.

Gjin Zenebishi, i biri i Depës, u kthye nga mërgimi duke zbarkuar në bregdetin shqiptar pranë Butrintit. Me ushtrinë që organizohej këtu marshoi nëpër rrethinat e Gjirokastrës në drejtim të Kosturit, ku forcat e tij u sulmuan në befasi dhe u shpartalluan nga një ushtri osmane dhe vetë Gjini mbeti i vrarë.

Në fund të vitit 1443 lufta çlirimtare e shqiptarëve mori hov të mëtejshëm nga zhvillimi i ngjarjeve në Ballkan.



Në tetor të vitit 1443 trupat hungareze të komanduara nga Janosh Huniadi, pasi kaluan Danubin, u futën në thellësi të Ballkanit dhe filluan "Fushatën e Gjatë" që vazhdoi deri në fillim të vitit 1444. Ato marshuan në drejtim të viseve verilindore shqiptare. Kudo ato gjetën gatishmërinë e banorëve të krahinave, ku kalonin për të luftuar së bashku kundër të njëjtit armik. Vetë Huniadi shkruante ato ditë se ushtria e tij po "rritej nga dita në ditë me shumë bullgarë, arbër, serbë, boshnjakë".

Beteja u zhvillua, më 3 nëntor

1443, në afërsi të Nishit, ku trupat osmane u thyen dhe u tërhoqën të shpartalluara. Ushtria e J. Huniadit vazhdoi marshimin në thellësi të zotërimeve osmane gjatë një dimri të ashpër dhe u fut në Bullgari, duke zbritur deri në juglindje të Sofjes. Gjatë 5 dhe 6 dhjetorit 1443 ushtria e J. Huniadit pësoi disfatë në Vasilicë dhe filloi tërheqjen. Pas një muaji, më 5 janar 1444, ajo pësoi një disfatë të dytë në Pirot (në juglindje të Nishit). Me humbje të ndjeshme të

e funksionarit të lartë osman, atë të sanxhakbeut të Nikopolit. Shpartallimin e forcave osmane në betejën e 3 nëntorit 1443 dhe vazhdimin e marshimit të trupave të J. Huniadit në drejtim të Bullgarisë, Skënderbeu e gjykoi si çastin më të përshtatshëm për çlirimin e tokave shqiptare. Pasi grumbulloi rreth vetes disa qindra bashkatdhetarë pjesëmarrës në betejën e Nishit, dhe i shoqëruar nga i nipi Hamza Kastrioti, Skënderbeu mori rrugën

*Në shtator të vitit 1443 Gjergj Arianiti sulmoi forcat osmane në lindje të zotërimeve të tij dhe i dëboi pushtuesit nga shumë krahina të Shqipërisë Qendrore. Fitoret e tij ndikuan në jetën politike të Shqipërisë dhe patën jehonë edhe në vendet e tjera.*

shkaktuara edhe prej kushteve natyrore të stinës, në fillim të shkurtit të vitit 1444, ushtria e J. Huniadit arriti në Budapest me një efektiv disa herë më të vogël nga numri fillestar i luftëtarëve, kur nisi fushatën në tetor të vitit 1443. Sidoqoftë, ngjarjet e mësipërme ndikuan në jetën politike të Ballkanit. Në gusht të vitit 1444, me miratimin e sulltan Muratit II dhe me kufij të rrudhur, u rimëkëmb Despotati i Rashës.

Në betejën e Nishit, të 3 nëntorit 1443, ndodhej edhe Gjergj Kastrioti-Skënderbeu, që kishte detyrën

në drejtim të atdheut.

Në fillim Skënderbeu hartoi planin për ringritjen e shtetit të Kastriotëve, që siç është shprehur në fillim të vitit 1445, formohej nga dy pjesë të mëdha "nga Dibra dhe Mati", që i ndante lumit Drin. Dibra, sipas konceptit të kohës për shqiptarët, të shprehur, p.sh., nga Marin Barleti dhe nga Gjon Muza-ka, shtrihej në lindje deri në masivin malor të Mokrës (malet Jakupicë), kurse Mati deri në Detin Adriatik.

Gjatë kthimit nga Nishi, Skënderbeu arriti në Fushë-Darda-

ni, vijoi rrugën Prishtinë-Prizren, që ishte e lirë nga osmanët, dhe më tej zbriti në rajonin e Dibrës. Kjo ishte pjesa më e begatë dhe më e populluar e zotërimeve të Kastriotëve, prandaj ai e përmend atë të parën kur e cilëson veten dhe të vëllanë, Stanishën, si “zotë të Dibrës dhe të Matit”.

Dibra përbëhej nga dy rajone: nga Dibra e Poshtme dhe Dibra e Sipërme. E para ishte zonë fushore dhe shtrihej përgjatë rrjedhjes së sipërme të lumit Vardar dhe arrinte në lindje, duke i përfshirë ato, deri te ngushticat e Dervenit në afërsi të Shkupit. Burimet historike të shek. XV, madje edhe më të hershme, tregojnë se afër Gostivarit e në veriperëndim të tij gjendej qendër-banimi më i madh i atij rajoni, fshati Dibrishë (Debrishë), që është edhe sot, emrin e të cilit ka pasur për një kohë edhe rajoni në rrjedhjen e sipërme të lumit Vardar. Rruga që lidhte Kërçovën me rajonin e Gostivarit në dokumentet mesjetare del e emërtuar “Rruga Kërçovë-Dibër” dhe banorët e fshatit Llopushnik, në juglindje të Gostivarit, përmenden në to si ruajtës të saj. Edhe në krahinën e Dervenit, që shtrihet në lindje të Tetovës, gjendet mikrotoponimia Dibër, që në sllavishten e vjetër kishtare (dëbër) ka kuptimin luginë, grykë. Ky duhet të ketë qenë emërtimi i vjetër i kësaj krahine, të cilin pushtuesit osmanë e zëvendësuan me fjalën përkatëse të tyre derven (derbend). Kjo shërben si një e dhënë që tregon se shtrirja lindore e Dibrës së Poshtme arrinte deri në afërsi të Shkupit. Prandaj osmanët në shek. XV, kur bënë ndarjen e tyre administrative, për rajonin Gostivar-Tetovë përdorën një emërtim osman (vilajeti ose nahija e Kalkandelenit) për ta dalluar nga njësia administrative në perëndim të saj (nahija e Dibrës). Në këtë të fundit, edhe pse mbante emrin e Dibrës, gjatë shek. XV nuk kishte asnjë qendër banimi ose mikrotoponimi tjetër me këtë emër.

Në jug të Dibrës së Poshtme shtrihej Dibra e Sipërme, që ishte kryesisht një rajon malor me shtrirje të gjerë. Këtu, në pjesën verilindore të Dibrës së Sipërme, në veri të Krushevës e në segmentin rrugor Përlep-Kërçovë, ishte qyteti mesjetar Debërshtë, emër që vazhdon ta mbajë edhe sot. Kurse në veri të liqenit të Ohrit ishte qyteti mesjetar e nahija Debërc, emër që e mban ende sot krahina e luginës së lumit Sasheska në verilindje të Strugës, nëpërmjet së cilës kalon rruga nga Struga dhe Ohri për në Kërçovë. Martin Segoni, Gjon Muzaka etj., kanë rrëfyer se qyteti i Ohrit ishte në Dibër.

Këto dëshmojnë për shtrirjen e gjerë të rajonit të Dibrës së Sipërme gjatë shek. XV dhe mesjetës në përgjithësi. Në Dibër Skënderbeu qëndroi disa ditë, ku në fshehtësi mblodhi krerët e vendit dhe u tregoi planin e veprimeve. Së pari ai vuri

nën kontroll Dibrën e Poshtme, e cila vetëm në lindje ruhej nga dy garnizone të vogla, të vendosura në kështjellën e Kalkandelenit (Tetovës) dhe, në lindje të saj, në kështjellën e Sobrit, që ngrihej në krahinën e Dervenit për të kontrolluar ngushticat e rrugës Tetovë-Shkup. Sobri ka qenë në fshatin e sotëm Orashko Gradishte, ku edhe sot ruhen rrënojat e një kështjelle. Të dyja këto kështjella, e Tetovës dhe e Sobrit, duhet të kenë kaluar në duart e Skënderbeut. Me këto



masa Skënderbeu vuri në kontroll një rrugë tregtare shumë të rëndësishme, që kalonte në rajonin më të pasur të zotërimeve të tij dhe që lidhte viset perëndimore me Shkupin, ku kishte selinë e vet bejlerbeu i Rumelisë. Në këtë mënyrë ai ndërpreu lidhjet e kryeqendrës së Rumelisë me garnizonet osmane, që gjendeshin të shpërndara në viset e tjera shqiptare, të cilat shtriheshin në perëndim, të Shkupit.

Për t`u mbrojtur nga ndonjë sulm i papritur i forcave osmane, Skënderbeu vendosi roje në pozicionet kyçe të rrugëkalimeve dhe dërgoi në drejtim të Krujës një grup luftëtarësh, duke i fshehur në pyjet dhe grykat pranë saj. Kurse më pas Skënderbeu, i shoqëruar nga një numër i vogël luftëtarësh, u nis vetë për në Krujë. Duke e ditur se me forcën e armëve ishte i pamundur pushtimi i kështjellës së saj, Skënderbeu u paraqit pranë autoriteteve osmane të Krujës si i riemëruar në detyrën e subashit të saj, funksion që e kishte ushtruar në fund të viteve 30 të shek. XV.

Pasi mori në dorëzim Krujën, Skënderbeu futi natën në kështjellë bashkëluftëtarët e fshehur në rrethinat e saj dhe, në bashkëpunim me krutanët, paralizoi garnizonin osman. Ai i la të lirë ushtarët osmanë që të largoheshin nga Shqipëria, duke përfshirë edhe dizdarin e kështjellës, Ballabanin, i cili pas dy dhjetëvjeçarësh do të vihej në krye

të trupave osmane për të rimarrë Krujën.

Kur zbardhi dita, më 28 nëntor të vitit 1443, krutanët i kishte pushtuar një gëzim i papërmbajtur dhe, siç shprehet Barleti, “të gjithë kishin në gojë lirinë, kudo oshtinte zëri i ëmbël i lirisë”. Në prani të gjithë krutanëve mbi muret e kështjellës së Krujës u ngrit flamuri i lirisë, ai i Kastriotëve. Me këtë rast, sipas Marin Barletit, Skënderbeu u mbajt i banorëve të Krujës një fjalim të zjarrtë e plot patos patriotik. Duke

vlerësuar lart gatishmërinë e madhe të shqiptarëve për të luftuar, sipas M. Barletit, Skënderbeu iu drejtua krutanëve me fjalët lapidare: “Armët nuk ua solla unë, por ju gjeta të armatosur! Lirinë e pashë se e keni kudo: në kraharor, në ballë, në shpatat e në ushtat tuaja”. Lajmi i fitores historike, i çlirimit të Krujës, u përhap me shpejtësi dhe u prit me gëzim të papërshkruar në mbarë vendin. Ai i dha hov të paparë luftës çlirimtare dhe i paralizoi plotësisht forcat osmane, duke i vënë ato në gjendje frike e paniku.

Pasi mori Krujën, Skënderbeu në bashkëpunim edhe me të vëllanë, Stanishën, hyri menjëherë në bisedime me banorët e zotërimeve të Kastriotëve si dhe me fisnikët shqiptarë që kishin lidhje farefisnie ose krushqi me Kastriotët. Këtyre ai u parashtroi planin e veprimeve të mëtejshme për çlirimin e kështjellave dhe të krahinave të tjera të Shqipërisë.

Forcat e Skënderbeut, pa humbur kohë, nisën sulmet për çlirimin e një vargu kështjellash të tjera në afërsi të Krujës. Së pari morën Petrelën dhe pas saj iu drejtuan dy kështjellave në lindje të Krujës, Gurit të Bardhë dhe Stelushit, të cilat kontrollonin rrugët tregtare që lidhnin viset bregdetare me ato lindore. Luftëtarët e Skënderbeut ndërkohë kaluan në Dibrën e Sipërme, ku në bashkëveprim me trupat e Gjergj Arianitit e të Zahari Gropës çliruan

qytetin e Ohrit dhe kështjellën e Sopotnicës (Sfetigradit), të ngritur në veriperëndim të Manastirit dhe që kishte një pozicion shumë strategjik për kontrollin e rrugëve që lidhnin Përlepin e Manastirin me rajonet në perëndim të tyre. Bashkë me Ohrin dhe Sopotnicën, në duart e shqiptarëve ranë edhe Struga, Kërçova, si dhe kështjella më të vogla që kontrollonin rrugët tregtare në hapësirat e Dibrës së Sipërme. Gjithashtu Skënderbeu në jug të Shkupit mori për herë të parë

në zotërim të Kastriotëve rajonin malor të Mokrës (malet Jakupice). Ai vuri nën kontroll rrugën e rëndësishme Shkup-Kërçovë, traseja e së cilës kalonte përgjatë luginës së lumit Treska. Po kështu vepruan fisnikët shqiptarë në viset e tjera të vendit. Në Shqipërinë e Epërme kështjellën e Jeliçës (Jenipazarit-Pazarit të Ri) dhe atë të Zveçanit duhet t`i kenë marrë Spanët, kurse rajonin e Pejës Dukagjinët. Edhe Stefan Gjurashi (Cërnojeviçi) nuk qëndroi duarkryq. Më parë, me ndihmën e vjehrrit të tij, Gjon Kastriotit, dhe tani me përkrahjen e Skënderbeut, Stefani u fuqizua, zgjeroi kufijtë e zotërimeve të tij dhe si kryeqendër të tyre bëri Zhabiakun.

Në jug të vendit viset e çliuara arritën deri në brigjet e lumenjve Devoll e Seman. Revolta e përgjithshme anti-osmane u shtri edhe në Shqipërinë e Poshtme. “Turqit, - shkruante në dhjetor të vitit 1443 bajli Venecian i Korfuzit, - i ka pushtuar një tmerr i madh dhe me nxitim ata të Vlorës, të Janinës dhe të Gjirokastrës po përpiqen të fortifikohen”. Por, me gjithë situatën shumë të favorshme, për mungesë organizimi të qëndresës anti-osmane nga fisnikët vendas, kështjellat kryesore të Shqipërisë së Poshtme, që nga Berati e më në jug, mbetën në duart e osmanëve.

Me çlirimin e një vargu kështjellash, shqiptarët u hoqën osmanëve qendrat kryesore ushtarake në viset e çliuara, të cilat i shndërruan në baza të fuqishme për mbrojtjen e tyre. Në hapësirat shqiptare që u çliruan me kryengritjen e përgjithshme të vitit 1443 gjendeshin zotërimet e shumë fisnikëve shqiptarë. Më të rëndësishmet prej tyre i përbënte shteti i Kastriotëve, që u ringrit shumë shpejt nën drejtimin e Skënderbeut e të vëllait të madh të tij, Stanishës. Ai gjendej në qendër të viseve të lira, shtrihej në vijën

detare Lezhë-Durrës dhe arrinte në lindje deri në afërsi të Shkupit. Në veri të shtetit të Kastriotëve shtriheshin zotërimet e Dukagjinëve, të Zahariajve, të Spanëve, të Dushmanëve, të Gjurarshëve etj. Në gjirin e tyre përfshihej Rrafshi i Dukagjinit e Drenica, krahinat e Plavës e të Gucisë, të Jeliçës (Sanxhakut), të Gentës (Zeta) etj. Në veri të kësaj hapësire, disa muaj më pas, do të rikrijohej Despotati i Rashës me kryeqytet Smederevën.

Në jug të Kastriotëve ishin zotërimet e katër familjeve të rëndësishme: të Arianitëve, të Topiajve, të Gropajve dhe të Muzakajve, që ishin kufitare me viset e pushtuara prej osmanëve, prandaj mbi to do të binte edhe pesha kryesore e luftës kundër pushtuesve osmanë. Zotërimet e tyre arrinin në jug deri te lumenjtë Devoll dhe Seman, kurse në lindje shtriheshin deri në afërsi të Manastirit. Çlirimi i viseve të gjera në Shqipërinë Qendrore e të Epërme në vitin 1443 shënonte ngjarjen më të rëndësishme në luftën e gjatë e të ashpër që shqiptarët kishin zhvilluar deri në atë kohë kundër Perandorisë Osmane. Çlirimi u krijoi mundësinë një pjese të rëndësishme të shqiptarëve të jetonin të lirë, kurse vitet që vijuan, të luftës kundër pushtuesve të huaj, forcuan përgjithësisht te shqiptarët tiparet e luftëtarëve të lirisë, si dhe vetëdijen e tyre kombëtare.

Mundësi të *shkëlqyera* studimi në *akademitë ushtarake* më të mira në botë.  
*Tetë bursa* të plota studimi, **6** në Akademinë e Marinës në SHBA dhe 2 në Itali, njëra për karabinieri në Modena, tjetra për detari në Livorno.

Gjithçka mbulohet nga shtetet pritëse.

*Forcat e Armatosura* shqiptare garantojnë *punësim dhe karrierë të sigurt* pas përfundimit të studimeve.

Kriteret dhe afatet i gjeni në linqet e mëposhtme:

<https://bit.ly/3SIJ2Vd>

<https://bit.ly/3FqoyxI>



REPUBLIKA E SHQIPËRIË  
MINISTRIA E MBROJTJES

# 8 BURSA STUDIMI

NË AKADEMITË  
USHTARAKE MË TË  
MIRA NË BOTË